



A K E P
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

**AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE,**

AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

DHE

FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Këtëj e tutje, Palët,

Të vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional, në fushën e ndërtimit të infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike, dhe

Të bindur që ky bashkëpunim i ndërsjellë, do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë,

Me dëshirën e mirë për të kontribuar në bashkëpunim nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet tre institucioneve,

Duke deklaruar gatishmërinë për koordinimin e veprimeve / punëve lidhur me ndërmarrjen e masave për zbatimin e kërkesave teknike që duhet të përmbushen në zhvillimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike,

Duke riafirmuar vendosshmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë konstruktive në këtë proces të ndërtimit të infrastrukturës së ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike, duke u bazuar në legjislacionet respektive të të tre institucioneve,

Kanë Vendosur që në përmbushje të objektivave të parashikuara sa më lart, të konkludojnë Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

Palët do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet që do të ndërmarrin, me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga:

- Ligji nr. 9918, datë 18.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”,
- Ligji nr.10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, si edhe të gjitha akteve të nxjerra në bazë e për zbatim të ligjeve sa më sipër.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 8.4.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 468, datë 30.5.2013, të KM, “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e broadband-it””,

Neni 2

Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

Të tre institucionet konfirmojnë angazhimin për bashkëpunim, mbi parimin e reciprocitetit. Të tre institucionet do të koordinojnë veprimet dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm në fushën e ndërtimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

Neni 3

Angazhimet e palëve

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), angazhohen që të informojnë paraprakisht AKEP-in mbi:
 - a. segmentet rrugore që do të ndërtohen ose do të rikonstruktohen,
 - b. sipërmarrësit e interesuar për të marrë në përdorim infrastrukturën për qëllime të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike,
 - c. sipërmarrësit e interesuar për të investuar në infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike në segmente të ndryshme rrugore,
 - d. kontratat e lidhura me sipërmarrës të komunikimeve elektronike për marrjen në përdorim të infrastrukturës ose për investim në infrastrukturë.
2. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), angazhohet të informojë Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) mbi:

- a. sipërmarrësit e interesuar për të marrë në përdorim infrastrukturën për qëllime të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike,
- b. sipërmarrësit e interesuar për të investuar në infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike në segmente të ndryshme rrugore.

Neni 4

Përdorimi i informacionit

1. Informacioni i këmbyer mes palëve është vetëm për qëllim të ndërtimit dhe përdorimit të infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike.
2. AKEP do të publikojë në faqen elektronike të tij informacion për rrugët në ndërtim, që do të ndërtohen apo rikonstruktohen, me qëllim marrjen e interesit nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për marrjen në përdorim ose investim në këtë infrastrukturë.

Neni 5

Komunikimi i palëve

- Palët marrin përsipër të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore/electronike në adresat respektive të personave të kontaktit.
- Palët do të caktojnë një person kontakti me njohuri të specializuara të fushës që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe bashkërendimin / koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- Me anë të përfaqësuesve të tre palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 6

Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të tre Palëve.

Neni 7

Afati

Kjo marrëveshje lidhet me afat të pacaktuar. Marrëveshja mund të përfundojë _____. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga palët. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa u përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 8

Nëshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja e mësipërme do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga titullarët e institucioneve palë në këtë Marrëveshje.

Nëshkruar sot më datë 13.05.2016, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në AKEP, dy depozitohen pranë ARRSH dhe dy depozitohen pranë FSHZH.

PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE:

KRYETARI

Z.PIRO XHIXHO

PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR:

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Z.DASHAMIR XHIKA

PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT:

DREJTORI EKZEKUTIV

Z. BENET BECI